



Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 pika c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, datë: 4 qershor 2008"), nenit 11, 13 dhe nenit 14. të Ligjin Nr.2003/24 për Sport, nenit 5 të Rregullorës Nr.01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave të MAPL Nr.0203 – 76, të dates 24.01.2013, dhe nenit 9, paragrafi 1, pika c) të Statutit të Komunës së Pejës 01.Numër: 09 – 8103, datë 29.shtator 20008, Kuvendi Komunal Pejë, në mbledhjen e mbajtur me date 27. Shkurt 2015, miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE NR. 06/2015

Për vlerësimin, ndarjen e dekoratave dhe shpërblimeve për sportistët e komunës së Pejës për sukseset e arritura në gara sportive

Neni 1.

- i. Me këtë rregullore përcaktohen dhe sqarohen kriteret për vlerësimin, ndarjen e dekoratave dhe shpërblimin e sportistëve, klubeve sportive dhe personave fizik dhe juridik të dalluar që kontribuojnë në zhvillimin e sportit në komunën e Pejës.

Neni 2.

Fushëveprimitaria

- i. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga klubet, sportistët dhe institucionet e komunës së Pejës.

Neni 3.

Kategorizimi dhe Kriteret

- i. Shpërblimin dhe dekoratat sportive ndahen për sportistët, trajnerët dhe për klubet sportive të cilët garojnë dhe arrijnë suksese në këto kategori:
 - a) Lojërat Olimpike dhe Paraolimpike;
 - b) Kampionate Botërore;
 - c) Kampionatet Evropiane;
 - d) Kampionate Ballkanike;
 - e) Lojërat Mesdhetare;
 - f) Kampionatet Vendore.
- ii. Kriteret të cilat merren si bazë për vlerësimin dhe shpërblimin e klubit, sportistit dhe personit fizik dhe juridik në nivel komunal janë:

- a) Rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare, shiko rregulloren me Nr: 15/2013 e Qeverisë së Kosovës, neni 5.1,2,3,4.
 - b) Rezultatet e arritura në garat shtetërore të organizuara nga federatat sportive të Republikës së Kosovës, ku në kupa dhe kampionatet ekipore marrin pjesë së paku 8 ekipe, si dhe në garat individuale ku marrin pjesë së pakut 8 garues.
 - c) Popullariteti i sportit ku garon sportisti dhe klubi.
 - d) Niveli Profesional i sportit ku garon sportisti apo klubi.
 - e) Diciplina dhe sjelljet e sportistit dhe kryesive të klubeve sportive.
- iii. Sportistëve dhe klubeve që arrijnë të fitojnë medale të artë, të argjendë dhe të bronzët në garat zyrtare ndërkombëtare, komuna e Pejës ndanë shpërblim financiar vjetor dhe dekorata për merita.
 - iv. Trajnerëve të sportistëve dhe të klubeve që shpërblehen nga komuna sipas kësaj rregulloreje ju ndahet shpërblimi në shumë prej 50%. Të shpërblimit të ndarë për sportistin apo klubin.
 - v. Për sportistët dhe klubet që fitojnë vendet e para në nivel shteti, komuna ndanë shpërblim financiar vjetor për klubin dhe dekorata për merita për secilin sportist.
 - vi. Për sportistët dhe klubet që arrijnë vendet e dyta dhe të treta, komuna ndanë dekorata për klubin dhe për sportistët e dalluar për merita.
 - vii. Shumën e shpërblimeve të Komunës e përcakton Kryetari i Komunës me propozim të DKRS.
 - viii. Vendimin mbi ndarjen e shpërblimeve dhe dekoratave për sportistët, klubet dhe kontribuesit e sportit i bjenë bordi i drjetorëve (Kryetari) me propozim të DKRS.
 - ix. Shpërblimet ndahen në fund të vitit kur mbledhen të gjitha rezultatet e vitit dhe vertetohen nga DKRS.

Neni 4.

Vlefshmëria e rezultateve

- i. Rezultatet e arritura nga sportistët dhe klubet janë të vlefshme vetëm kur ato janë të konfirmuara nga Federatat Sportive përkatëse dhe janë të publikuara në tablot informative dhe në gazetata zyrtare të tyre.
- ii. Në rast se rezultatet e anulohen për shkak të evidentimit të shkeljeve disiplinore nga ana e federatave kompetente, edhe komuna e Pejës do të vepron njëjtë duke anuluar vendimin.

Neni 5.

E drejta për Shpërblim dhe Mirënjohje Sportive

- i. Të drejten për Shpërblim dhe për Dekorata Sportive nga ana e Komunës ju takon sportistëve të cilët në momentin e arritjes së rezultatit kanë qenë anëtarë të lidhjes/klubit të regjistruar në DKRS (Sektorin e Sportit).

- ii. Të drejtën për Shpërblim dhe Dekorata Sportive e kanë sportistët që arrijnë suksese kulminante në nivel mbarëkombtar, dhe ndërkombëtarë në konkurrencën e senjorëve.
- iii. Për sportistët e ri junior (deri në U 23) shpërblimet komunale do të përcaktohen sipas modelit të nenit 6. Të Rregullorës Nr.15/2013 të Qeverisë së Kosovës.
- iv. Të drejtën për Shpërblim dhe Dekorata Sportive e kanë klubet sportive profesioniste të cilat arrijnë suksese kulminante në nivel shtetror, kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- v. Të drejtën për Shpërblim dhe Dekorata Sportive e kanë kontribuesit e dalluar sportiv që kanë ndikuar drejtëpërdrejt në rezultatet kulminante të sportistit apo klubit.

Neni 6.

Ndarja e Shpërblimeve dhe Dekoratave

- i. Shpërblimet dhe Dekoratat ndahen në një ceremoni vjetore nga Kryetari, Drejtori i DKRS-së dhe autoritete sportive të caktuara nga këshilli organizativ.

Neni 7.

Procedurat

- i. Klubet sportive që veprojnë në komunën e Pejës dhe menaxherët e sportistëve individual duhet ta paraqesin kërkesën me shkrim pranë DKRS-së duke dhënë arsyetimin e bazuar për të propozuar klubin, sportistin apo kontribuesin e dalluar për shpërblim dhe për mirënjohje.
- ii. DKRS duke u konsultuar me Këshillin profesional të sportit dhe duke u bazuar në kategoritë dhe kriteret e shënuara më sipër, e rekomandon klubin, sportistin dhe kontribuesin sportiv për të qenë përfitues i shpërblimit apo dekorates.
- iii. Kryetari i komunës, pas shqyrtimit të rekomandimeve merr vendim për shpërblimin e klubeve, sportistëve, trajnerëve dhe kontribuesve të dalluar sportiv.
- iv. Shpërblimet Komunale të vertetuara me këtë Rregullore paguhen në xhirollogarinë e klubit gjegjësisht sportisti i cili e fiton të drejtën në shpërblim.
- v. Për ekzekutimin e shpërblimeve kujdeset DKRS dhe Drejtorati i Financave të komunës së Pejës.
- vi. Shpërblimet dhe Dekoratat regjistrohen në arkivin e DKRS-së.

Neni 8.

Hyrja në fuqi

- i. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb – faqen e Komunës.

I.Nr. 066 - 4450

Pejë, date: 27.Shkurt 2015

KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj

Dr. Islam Husaj